



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

SESSION INFORMUES

LANSIMI I SKEMËS SË GRANTEVE PËR ENERGJI TË PASTËR

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht KIESA, bashkë me Ministrinë e Ekonomisë dhe LuxDev-in, më datë 10.09.2025 kanë nënshkruar marrëveshjen për Skemën e granteve për Energji të Pastër. Qëllimi i kësaj skeme është të stimulojë angazhimin e sektorit privat në tranzicionin energjetik të Kosovës duke përdorur teknologji të qëndrueshme të prodhimit, duke rritur eficiencën e energjisë dhe duke ulur kostot operative.

Me këtë rast ftohen Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim, që të bëhen pjesë e Skemës së Granteve për Energji të Pastër. Përveç tyre, të drejtë aplikimi kanë edhe kompanitë e tjera që kanë hyrë në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike me aktivitete parësore ose dytësore në prodhim dhe përpunim. Vlera totale e skemës është 1 milion euro e financuar nga Qeveria e Duketit të Madh të Luksemburgut.

Skema bashkëfinancon investime që përmirësojnë performancën energjetike dhe ulin kostot e energjisë elektrike përmes: (i) gjenerimit të energjisë së ripërtërishme (sistemet solare fotovoltaike dhe termike), (ii) ruajtjes të energjisë elektrike nga sistemet solare fotovoltaike përmes baterive, (iii) masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat e bizneseve, dhe (iv) pajisjeve që ulin konsumin e energjisë në linjat e prodhimit.

Prandaj, me qëllim të informimit dhe udhëzimit të bizneseve për mënyrën e aplikimit, KIESA, në kuadër të MINT, fton bizneset në sesion e parë informues.

Sesioni mbahet më 10 tetor 2025, në ora 10:00, në Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës.

Singerisht,

Zef DEDAJ

U.d. i Drejtorit të Përgjithshëm i KIESA-s